



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-5854/1 të datës 14.06.2022, me pretendime për keqpërdorim të numrit të telefonit të personit fizik, **HIDHET POSHT**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për arsye se në denoncim nuk ka pretendime për veprime të paligjshme të personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve zyrtare.

Lënda me numër 12-5854/1 të datës 14.06.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 14 qershor 2022, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendime për keqpërdorim të numrit të telefonit të personit fizik dhe është konstatuar rasti numër 12-5854/1 i datës 14 qershor 2022.

Në denoncim, parashtruesi pa denoncuar veprime korruptive dhe pa treguar zyrtarë, paraqet pretendime të përgjithshme për veprime të kryera nga një person fizik që kanë pasur për qëllim keqpërdorimin e numrit të telefonit të parashtruesit, në dëm të tij.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konkludoi se pretendimet e denoncuar në këtë rast nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente kompetente veprim për rastin në fjalë. Në të njëjtën kohë, KSHPK-ja vlerësoi se kërkesa

nuk përmbante pretendime apo indikacione për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK -ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R:M

Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

